

Informacion Mujor – Shkurt 2026

Emri i Fondit	Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL Pro Pension
Struktura Ligjore	Fond Pensioni* Licencuar nga AMF me vendim nr. 251, datë 20.12.2022
Administrimi i Fondit	SIGAL UNIQA INVEST- Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive Sh.a.
Themeluar	Janar 2006
Monedha	Lekë
Banka Depozitare	Banka Kombëtare Tregtare
Auditues	Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k.

*Rregulluar nga Ligji nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit Privat"

Komision në Hyrje	0%
Komision në Dalje	0%
Komision Vjetor Administrimi	1.50%
Penalitet për tërheqje të parakohshme	Sipas Rregullores së AMF
Komision Performance	0%
Shuma fillestare e kuotës	1.000 Lekë
Kontributi fillestar minimal	1.000 Lekë
Kontributi minimal pasues	1.000 Lekë

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivat e Investimit

Fondi i Pensionit ka për qëllim të maksimizojë kthimin afatgjatë të investimit nëpërmjet administrimit të kujdesëshëm dhe konservator të rrezikut të investimit.

Politika e Investimit

Asetet e Fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij dhe për t'ju siguruar atyre një të ardhme të sigurt.

Instrumentat në përbërjen e portofolit janë: (i) tituj të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me maturitete të ndryshme, (ii) mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe (iii) Depozita me afat në banka të nivelit të dytë të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Të dhënat kryesore për Fondin në 28 Shkurt 2026

Vlera Neto e Aseteve	85,486,712.59 Lekë
Numri i anëtarëve	729
Çmimi i Kuotës	1,075.6578 Lekë
*Fitimi vjetor (28/02/25-28/02/26)	4.40%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

**Norma e kthimit nga investimi është e ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbën garanci për të ardhmen.



Figura 1-Përbërja e portofolit sipas kategorive





Figura 2-Përbërja e portofolit sipas maturitetit të mbetur

Performanca e Fondit deri në 28.02.2026


Gjatë muajit Shkurt 2026 çmimi i kuotës dhe Vlera Neto e Aseteve të Fondit kanë patur një trend rritës krahasuar me muajin paraardhës.

Norma e rritjes të çmimit të kuotës për 12 muajt e fundit ka rezultuar 4.39%.

Rekomandohet që anëtarët të qëndrojnë sa më gjatë në fond në mënyrë që të përfitojnë maksimalisht nga kthimi i investimit.



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit



Profili i Rrezikut dhe Përfitimit të Fondit tregon luhatshmërinë historike të çmimit të kuotës.


Për Fondin e Pensionit privat me pjesëmarrje të hapur SIGAL PRO Pension, treguesi është në nivelin 1, ose nivelin më të ulët të rrezikut.

Fondi ndodhet në këtë kategori pasi portofoli i investimeve është në pjesën kryesore të tij në Tituj të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

Kategoria e rrezikut mund të ndryshojë në të ardhmen.

*** Të dhënat e mësipërme janë të ndryshueshme në varësi të kushteve të tregut dhe nuk përbëjnë garanci për të ardhmen.

Ecuria e Tregut të Titujve të Qeverisë Shqiptare



Tregu i Titujve të Qeverisë Shqiptare është karakterizuar nga një rritje e rendimentit për titujt për të cilët janë organizuar ankande gjatë këtij muaji. Raporti mesatar i mbulimit në ankandet e këtij muaji ka rezultuar 1.92, me rritje nga 1.67 raport mbulimi gjatë muajit Janar 2026.

Obligacioni 2 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.10 % nga 3.31% me një rënie prej 0.21% krahasuar me ankandin e muajit Janar 2026.

Obligacioni referencë 3 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.15% nga 3.50% me një rënie prej 0.35% krahasuar me ankandin e muajit Janar 2026.

Obligacioni referencë 5 vjeçar ka rezultuar me rendiment 3.66 % nga 3.91 % me një rënie me 0.25% krahasuar me ankandin e muajit Janar 2026.

Obligacioni 7 vjeçar ka rezultuar me rendiment 4.11% nga 4.77% me një rënie prej 0.66% krahasuar me ankandin e muajit Nëntor 2025.

Obligacioni 15 vjeçar ka rezultuar me rendiment 5.67% nga 6.19% me një rënie prej 0.52% krahasuar me ankandin e muajit nëntor 2025.

Për obligacionet me afat 10 dhe 20 vjeçare nuk është zhvilluar ankand gjatë muajit Shkurt 2026, ndaj i referohemi interesave të emetimeve më të fundit respektivisht 5.15% ankandi i obligacionit 10 vjeçar i Janar 2026, dhe 6.72% ankandi i obligacionit 20 vjeçar i Janar 2026.

Informacion Praktik

Trajtimi Fiskal

Fondi është një grup asetesh, i krijuar në bazë kontrate dhe pa personalitet juridik, për rrjedhojë nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat, ose taksës mbi vlerën e shtuar. Trajtimi fiskal i kontributeve të bëra nga anëtarët bazohet në nenet 156, 157 dhe 158 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat". Lidhur me detajet referojuni seksionit "Tatimi" të Prospektit të Fondit.

Deklaratë

Ky dokument ofron informacione kryesore për anëtarët në lidhje me Fondin e Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL Pro**. Anëtarët këshillohen dhe janë të ftuar të lexojnë Prospektin e Fondit në mënyrë që të marrin një vendim të mirë informuar. Informacioni i përditësuar mbi çmimin e kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Fondit të Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur **SIGAL Pro Pension** dhe në <https://fondisigal.com.al/>

Kontakt:

Rr. "Ukraina e Lirë", Tiranë

Email: info@fondisigal.com.al

Tel: +355 (0) 44 511 666